# DËSHMI ARKIVI

**A-477462**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dështon tentativa e hyrjes së 10 shqiptarëve në Angli, po transportoheshin me një gomone me motorë të fuqishëm! |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/deshton-tentativa-e-hyrjes-se-10-shqiptareve-ne-angli-po-transportoheshin-m-i589040` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 19:07:34 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 19:30:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `937620c47a84840f10dea08e814a70a222375b39fd464d3651c832e0acceb43a` |
| TEKSTI | `c7ece8336c0d561b85f670f130816222d52589e991238a1709d938b027ed7ffd` |
| PAMJA | `b2bc594ece5d24e61b1573ebadd9b031019943335ca0eb51388055a9ca5dc08d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8e9d81c894e7ea539d8f268081d92c4fde1a94fd9c2e822e6d058c8227e0c57d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `1fd94ce259103b5d3a93736e630fca63414b31f94ba022dd5b4f87109ff485e9` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8e9d81c894e7ea539d8f268081d92c4fde1a94fd9c2e822e6d058c8227e0c57d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English



# Dështon tentativa e hyrjes së 10 shqiptarëve në Angli, po transportoheshin me një gomone me motorë të fuqishëm!

TemA
28 Shtator 2026, 21:30Bota TEMA



Dhjetë persona janë arrestuar pasi një skaf me shtetas shqiptarë mbërriti në Mylor Harbour, në Cornwall të Britanisë së Madhe, ka konfirmuar Ministria e Brendshme britanike.

Policia e Devon dhe Cornwall u njoftua rreth orës 03:00 të së dielës, më 27 shtator, pas një raportimi se disa persona kishin zbritur nga një varkë në Mylor Harbour, ishin futur në një furgon dhe më pas ishin larguar nga zona, sipas televizionit ITV të cilit i referohet TCH.

Policia ka njoftuar se, efektivët mbërritën në vendngjarje dhe arrestuan dy shtetas shqiptarë nën dyshimin për shkelje të ligjeve të emigracionit.

Në operacion u angazhua edhe Roja Bregdetare britanike, ndërsa ekuipazhi i varkës së shpëtimit të Falmouth u aktivizua si masë paraprake rreth orës 04:00 të mëngjesit.

Një zëdhënës i Ministrisë së Brendshme britanike tha se autoritetet reaguan me shpejtësi ndaj një incidenti të rrallë dhe të izoluar në Mylor Harbour, Falmouth.

“Dhjetë persona janë arrestuar që atëherë. Një tjetër person, që besohet të jetë nën moshën 18 vjeç, i është referuar shërbimeve sociale”, tha zëdhënësi.

Sipas autoriteteve britanike, hetimi është ende në zhvillim dhe për këtë arsye nuk mund të jepen detaje të tjera.

Ministria e Brendshme theksoi se hyrjet e fshehta të këtij lloji janë të pazakonta dhe se mjeti i përfshirë ishte një skaf i vogël që transportonte një numër të kufizuar personash.

Hetimi tashmë drejtohet nga Njësia për Hetimet Kriminale dhe Financiare për Uellsin dhe Jugperëndimin e Britanisë.

---

## Lini një Përgjigje

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Sulm ajror në një treg në Myanmar, 33 të vrarë dhe 36 të plagosur (VIDEO)

21:00 Bota

[Forcat izraelite intensifikojnë bombardimet në Libanin jugor, sulmohet edhe një shkollë në qytetin Khiam]

20:20 Bota

[Thirrja për masa kundër Ebolës i kushtoi jetën, politikani rrihet për vdekje në Kongo]

20:10 Bota

[Starship hyn në orbitë për herë të parë, pavarësisht defektit të motorit dhe përfundon misionin me shpërthim në Paqësor]




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.